

STATUTI I SHOQERISE
"3MT" Sh.p.k

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me datë 22.03.2021 ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "3MT" SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

-Znj.Romina Ylli, shtetase shqiptare, lindur më 17.08.1988 në Lushnjë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal I85817061B, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

-Znj.Eni Shemaj, shtetase shqiptare, lindur më 28.03.1993 në Lushnjë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal J35328058R, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 2
Objekti

Shoqëria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:


2.1 Tregtimi i nje game te gjere produktesh kozmetike, parfumerie, bukurie, tekstile dhe shendeti si dhe produkte te tjera dytesore te kesaj kategorie si dhe import-eksport, tregtimi dhe shitja me shumice e pakice e tyre etj.

2.2 Gjithashtu shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

2.3 Shoqëria, me vendim të Asamblesë, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.



**Neni 4
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: *Rruga Ymer Kurti, Pallati Teknoprojekt, Nr. 9, Tirane.*

Kreu II Kapitali

**Neni 5
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100,000 (njëqind mijë) leke dhe nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

-Znj.Romina Ylli, shtetase shqiptare, lindur më 17.08.1988 në Lushnjë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal I85817061B, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, zoteron 1 (nje) kuote qe perben 50 % (pesëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

-Znj.Eni Shemaj, shtetase shqiptare, lindur më 28.03.1993 në Lushnjë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal J35328058R, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, zoteron 1 (nje) kuote qe perben 50 % (pesëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën masë ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerisë e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- 1.kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- 2.shitblerjes;
- 3.trashegimise;
- 4.dhurimit;
- 5.cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- dh) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "5" te kesaj pike;
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- gj) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h)perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- j)miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- k)ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9
Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete

elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndajen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

13.1 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqërisë:

-Znj.Eni Shemaj, shtetase shqiptare, lindur më 28.03.1993 në Lushnjë, identifikuar me leternjoftim, me nr personal J35328058R, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

13.2 Administratorja e Shoqërisë Eni Shemaj do të ushtroje kompetencat e saj në këtë detyrë për një periudhe 5 (pesë) vjecare, me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 14 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

- ç) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- e) raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Kreu IV

Viti financiar

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Kreu V

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- b) me hapjen e procedurave te falimentimit;



Neni 18
Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 19
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 20
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 21
Kopjet

Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Znj.Eni Shemaj

Eni Shemaj

[Signature]

Znj.Romina Ylli

Romina Ylli

[Signature]